

Mbahet një festival i poezisë në Prishtinë

"Polip" - është një festival ndërkombëtar i poezisë që do të sjellë në Prishtinë poetë të rinj nga Shqipëria, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Gjermania, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe shtetet e tjera, për t'i prezantuar tekstet e tyre dhe për të diskutuar rreth punës së tyre artistike. Festivali do të organizohet nga data 14 deri më 17 tetor

Qendra Multimedia e Prishtinës do të organizojë nga data 14 deri më 17 tetor edicionin e parë të festivalit të poezisë "Polip". Përse "polip"- ky emër për një festival poezie?

"Ne mendojmë se polip (polyp apo oktapodi) ka diçka të përbashkët me poetë dhe me poezinë", thuhet në sqarimin e organizatorit për këtë emërtim figurativ. Sikurse poeti, polipi punon me bojë. Ai përdorë bojë në një re të madhe për të krijuar një mirazh të tij me qëllim që t'i ngatërrojë grabitqarët dhe t'u ikë sulmit të tyre. Prandaj, si poeti, polipi është në gjendje të krijojë diçka fiktive. Arti kreativ polipian është i krahasueshëm me përdorimin poetik të gjuhës. Poeti krijon shtresa të ndryshme të kuptimit duke bashkuar fjalë në mënyra alternative, dhe në këtë mënyrë, krijon një artefakt të ri. Duke e vlerësuar këtë cilësi, organizatori ka zgjedhur polip-in si maskotë të këtij festivali.

"Polip" - është një festival ndërkombëtar i poezisë që do

të sjellë në Prishtinë poetë të rinj nga Shqipëria, Austria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Gjermania, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe shtetet e tjera, për t'i prezantuar tekstet e tyre dhe për të diskutuar rreth punës së tyre artistike. Ky festival prezanton zëra të rinj në gjuhë të ndryshme, duke shpalosur meloditë, muzikalitetin e ritmet e tyre specifike. Në këtë manifestim të poezisë nuk organizohet vetëm leximi, por edhe një program i posaçëm i koncerteve, poezive në rrugë, punëtore të përkthimit dhe të shkrimit të poezisë, diskutime e debate mbi rrjetet e letërsisë si dhe praktikë përkthimi.

Drejtorë artistikë të këtij edicioni të "Polip-it" janë Lucia Zimmermann dhe Jeton Neziraj. Disa nga poetët e shkrimtarët që do të marrin pjesë në polip janë: Luise Boege (Gjermani), Agron Tufa (Shqipëri), Nikola Madžirov (Maqedoni), Arben Idrizi (Kosovë), Tomislav Marković (Sërbia), Erëmir Çitaku (Kosovë), Shpëtim

Selmani (Kosovë), Mirko Božić (Bosnë dhe Hercegovinë), Mara Genschel (Gjermani), Ilir Ferrera (Shqipëri/Austri), Saša Ilić (Serbi), Trina Gojani (Kosovë), Ana Brnardić (Kroaci), Genc Salihu (Kosovë), Nora Prekazi (Kosovë), Sibylla Hausmann (Gjermani), Ballsor Hoxha (Kosovë), Miloš Živanović (Serbi) etj.

Debatet dhe leximet do të moderohen nga Shkëlzen Malliq, Lucia Zimmermann e Jeton Neziraj. Në organizimin e këtij edicioni janë të përfshirë edhe Qerim Ondozi e Nita Hasani. Si muzikantë që do të marrin pjesë Erëmir Çitaku e Agon Xharra, Visar Kuqi si dhe Jan Böttcher ndërsa, përveç nga vetë poetët, poezitë do të lexohen nga aktorët Anisa Ismaili dhe Shkëlzen Veseli.

Partnerë të festivalit janë: forumZFD, Tetris, Dit' e Nat' dhe Universiteti i Prishtinës. Festivali është financuar nga: Goethe Institut Beograd, Robert Bosch Stiftung, Komuna e Prishtinës, The Olof Palme International Center. **R. SYLAJ**